# DËSHMI ARKIVI

**A-447522**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Tre kontejnerë me mish me afat të skaduar, të destinuar për Kosovë kapen në Tivar |
| ADRESA | `https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/tre-kontejnere-me-mish-me-afat-te-skaduar-te-destinuar-per-kosove-kapen-ne-tivar` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 01:58:25 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 17:33:20 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `33cd43fb6b198ee02d28d4485da20e9e32e399d6d0de64c2679bb375375c8416` |
| TEKSTI | `ef62407f8777914c645d0654ae0ee1da374db0fcdc9339877839ff60540be756` |
| PAMJA | `bdfea4fc4cfea3ee21be6aeb5355e1c8d8864a80624cd736166675a2a95ceaba` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `74eabf8f54fe407c4856dadc73b51dce820a23a14e6bb19ff52a7cb34866fff9` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b76c045c30cbbea9eae7a42cd456659a809b623ad6b8382f688578771e275bcf` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/74eabf8f54fe407c4856dadc73b51dce820a23a14e6bb19ff52a7cb34866fff9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

LAJMET E MBRËMJES

# Tre kontejnerë me mish me afat të skaduar, të destinuar për Kosovë kapen në Tivar




Nga: Ilirjana Thaqi

15 shtator 2026 19:33

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Dogana e Malit të Zi ka parandaluar transitin drejt Kosovës të tre kontejnerëve me mish të ngrirë viçi me origjinë nga Brazili, pasi gjatë kontrollit është konstatuar se afati i përdorimit ishte i skaduar.

Sipas njoftimit të Drejtorisë së Doganës, kontejnerët ishin të destinuar për një blerës nga Kosova, i identifikuar me inicialet e firmës "A… SHPK". Ata ishin marrë nën mbikëqyrje doganore pa miratimin e autoritetit doganor të Malit të Zi.

"Inspektimi i mëtejshëm përcaktoi se, në objektin e magazinimit të ftohtë në Portin e Tivarit, punëtorë të angazhuar nga kompania kosovare, duke përdorur një mjet për heqjen dhe vendosjen e etiketave, kishin larguar deklaratat origjinale, në të cilat ishte shënuar afati i skaduar i përdorimit të mishit të ngrirë të viçit. Më pas, në produktet përkatëse ishin vendosur deklarata të reja, të falsifikuara, me një afat të ri ose të ndryshuar të përdorimit", thuhet në njoftimin e Administratës Doganore të Malit të Zi.

Autoritetet në Podgoricë kanë bërë të ditur se po hetohet edhe mundësia që produktet e kësaj kompanie nga Kosova të kenë arritur te subjekte të tjera afariste në Mal të Zi.

Sipas të dhënave në dispozicion të autoriteteve malazeze, një numër i subjekteve afariste në Mal të Zi që merren me përpunimin e mishit, furnizohen me produkte nga personi juridik

**Futboll.** Espi e shpëton Realin nga turpi

**Arbëri.** Kurti: Shqiptarët e Luginës kanë nevojë për bashkëpunim e përgjegjësi të përbashkët

**Arbëri.** Hehir: Turp i madh që një gjykatë e huaj që iu imponua Kosovës t'i shpallë fajtorë figurat e UÇK-së

**Futboll.** Zyrtare: Lionel Messi ftohet nga Argjentina

**Kulturë.** "Lufta nën akuzë..." demaskon rishkrimin e historisë së çlirimit

**Futboll.** Liverpooli eliminon Tottenhamin nga Kupa e Ligës

nga Kosova, i përmendur në njoftim.

KOHA ka adresuar pyetje në doganën e Kosovës në lidhje me këtë rast, por kanë munguar përgjigjet.
Përgjigje nuk ka ofruar as Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, institucion që ka udhëzuar që pyetjet t'i drejtohen Ministrisë së Bujqësisë.

Edhe



Arbëri • 10 o. më parë

Mali i Zi ndalon mishin e skaduar nga Brazili për në Kosovë, kërkon bllokimin e importit

Por, informacione nuk janë dhënë as nga ky dikaster qeveritar.

Kosova është e varur nga importi i mishit. Çdo vit, sipas të dhënave zyrtare, importon mish në vlerë miliona euro, kryesisht nga Brazili.

Në vitin 2025, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ndaloi përkohësisht mishin e pulës dhe produktet e tjera të shpendëve nga Brazili, pas shpërthimit të gripit të shpendëve në një fermë në këtë shtet.
Sipas statistikave zyrtare nga Departamenti i Bujqësisë i SHBA-së dhe Shoqata Braziliane e Eksportuesve të Mishit, Brazili ka eksportuar rreth 2 milionë tonë mish gjedhi në gjashtëmujorin e parë të vitit, duke mbuluar gati 25% të të gjithë eksportit botëror.

#MISHI #BRAZIL

## Artikuj të ngjashëm



Kronikë • 1 qer 2026

Në Viti sekuestrohen rreth 300 kg duhan, dyshohet se u kontrabandua nga Maqedonia e Veriut



Arbëri • 16 maj 2026

Kapen 200 kg mish doneri në një veturë pa kurrfarë kushtesh higjienike



Kronikë • 4 maj 2026

Dogana në Stuttgart sekuestron mbi 250 kg suxhuk nga Kosova



Arbëri • 27 shk 2026

Afati i koncentratit për pije që s'u lejua të hynte në Kosovë kishte skaduar para 5 muajsh

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing
Politika e privatësisë
Kushtet e përdorimit
Udhëzim për përdorimin e IA-së
Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Download on the App Store
GET IT ON Google Play

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.